



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE
PA1 Nr.08-313
13.05.2026
Shkup

Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 2, nenit 20, paragrafi (1), nënparagrafi 10¹, neni 24 dhe neni 79, paragrafët (1), (2) dhe (3) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24, 193/24 dhe 247/25), në pajtim me nenin 15, paragrafi (1) nënparagrafi 2, nenin 41, paragrafi (1), nënparagrafi 8 dhe nenin 59, paragrafët (1), (2) dhe (3) të Rregullores së Punës së Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, nr.ark.01-3632/1 të datës 22.08.2025 dhe nenin 51, paragrafët (1) dhe (2) nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.124/15), duke vepruar sipas Kërkesës për vazhdimin e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO PELA ShPKNJ P fsh. Konjari i Vogël (Malo Konjari), Prilep, (PA1 08/313 të datës 09.04.2026 me plotësim më datë 28.04.2026), gjatë seancës së 17-të të mbajtur më 12.05.2026, në pajtim me Konkluzionin, (nr.ark.02-2063/5 të datës 12.05.2026), miratoi:

VENDIM
për vazhdimin e lejes për transmetim në radio të
Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive
RADIO PELA ShPKNJ P fsh.Malo Konjari, Prilep

1. Leja për transmetim në radio e Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO PELA ShPKNJ P fsh.Malo Konjari, Prilep, (PA1 nr.08-313 të datës 03.07.2017), i vazhdohet për periudhë kohore prej 9 (nëntë) vitesh, për periudhën nga 15.05.2026 deri më 14.05.2035.
2. Agjencia e Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në pajtim me pikën 1 të këtij Vendimi, do t'i lëshojë leje të re Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO PELA ShPKNJ P fsh.Malo Konjari, Prilep.
3. Shoqëria Tregtare Radiodifuzive RADIO PELA ShPKNJ P fsh.Malo Konjari, Prilep, për periudhën për të cilën vazhdohet leja, është e detyruar të punojë në pajtim me Ligjin e Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, Ligjin e Mediave, dispozitat e miratuara në bazë të tyre, si dhe në pajtim me kushtet e përcaktuara në leje.
4. Ky Vendim është përfundimtar dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në faqen e internetit të Agjencisë.
5. Padia nuk e pezullon zbatimin e këtij Vendimi.

A r s y e t i m

Në nenin 79 (Kohëzgjatja e lejes për transmetim televiziv ose radio) paragrafi (1) nga Ligji i Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele - LShMAAV, përcaktohet se leja për transmetim televiziv ose radio e shoqërive tregtare radiodifuzive dhe institucioneve radiodifuzive jofitimprurëse, jepet për periudhë kohore prej nëntë vitesh, me mundësi vazhdimi.

¹ Nënparagrafët 8 dhe 9 fshihen, shih: nenin 8 nga Ligji i ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.248/18).

Në pajtim me nenin 79, paragrafi (2) të LShMAAV-së, leja për kryerjen e veprimtarisë radiodifuzive nuk mund t'i bartet një personi tjetër.

Leja për transmetim televiziv ose radio në pajtim me nenin 79, paragrafi (3) të LShMAAV-së, mund të vazhdohet me kërkesë të mbajtësit të lejes për një periudhë prej nëntë vitesh. Kërkesa dorëzohet në Agjenci në afat prej gjashtë muajsh para skadimit të vlefshmërisë së lejes. Këshilli i Agjencisë miraton detyrimisht vendim në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës për vazhdimin e lejes, me kusht që transmetuesi të mos ketë kryer shkelje në pajtim me paragrafin (4) të këtij neni.

Në pajtim me nenin 79, paragrafi (4) të LShMAAV-së, Këshilli i Agjencisë miraton vendim për refuzimin e kërkesës për vazhdimin e lejes nëse transmetuesi ka kryer shkelje serioze gjatë kohëzgjatjes së lejes dhe atë:

- së paku tre here gjatë kohëzgjatjes së lejes ka vepruar në kundërshtim me ndalesat e veçanta të nenit 48 të Ligjit, për të cilat ekzistojnë aktgjykime të plotfuqishme ose
- gjatë kohëzgjatjes së lejes, së paku në një cikël zgjedhor, mbulimi mediatik nuk është realizuar në mënyrë të drejtë, të ekuilibruar dhe të paanshme, për të cilat ekzistojnë aktgjykime të plotfuqishme.

Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (ShTR) RADIO PELA ShPKNjP fsh.Malo Konjari, Prilep, është mbajtëse e Lejes për transmetim në radio, (PA1 nr.08-313, datë 03.07.2017), me vlefshmëri prej 9 (nëntë) vitesh, duke filluar nga data 15.05.2017 deri më 14.05.2026 për transmetim përmes transmetuesit tokësor, në nivel lokal në zonën e komunës Krivogashtani, për shërbim programor radiofonik folës-muzikor me format të përgjithshëm në gjuhën maqedone.

Në faqen e internetit të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia), është publikuar formulari i Kërkesës për vazhdimin e lejes për transmetim TV/RA dhe shtojcat e kërkesës, edhe atë:

- Dokumenti përkatës si dëshmi se transmetuesit nuk i është shqiptuar masë sigurie - ndalesë për kryerjen e veprimtarisë nga regjistri ose evidenca (original ose kopje e noterizuar, jo më e vjetër se 15 ditë nga dita e dorëzimit), ose deklaratë e noterizuar nga drejtuesi i transmetuesit se nuk i është shqiptuar masë sigurie ndalesë për kryerjen e veprimtarisë, (jo më e vjetër se 15 ditë nga dita e dorëzimit);

- Deklaratë e noterizuar nga transmetuesi, se: do të respektojë karakteristikat teknike dhe parametrat e përcaktuar nga Agjencia e Komunikimeve Elektronike e RMV-së (AKE), në pajtim me Ligjin e Komunikimeve Elektronike (LKE) dhe dispozitat e nxjerra në bazë të ligjit; do të respektojë kushtet teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike në pajtim me Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për dhënien e lejes për transmetim televiziv dhe radio të miratuar nga Agjencia; nuk shkel dispozitat nga Kapitulli IV i LShMAAV-së; dhe se të dhënat e paraqitura në kërkesë janë të sakta dhe të gjitha shtojcat janë të vërteta dhe të vlefshme, si dhe

- Pëlqim për përpunimin e të dhënave personale të cituara në Kërkesë për vazhdimin e lejes për transmetim TV/RA.

Më datë 09.04.2026, ShTR RADIO PELA ShPKNjP fsh.Malo Konjari, Prilep, në pajtim me nenin 79, paragrafi (3) të LShMAAV-së, ka paraqitur Kërkesë për vazhdimin e lejes për transmetim në radio (PA1 nr.08-313, datë 09.04.2026) në formularin përkatës. Gjatë shqyrtimit të kërkesës, u konstatua se ajo është e parregullt dhe jo e plotë, për shkak se: vula (vula rrethore) që është përdorur në Kërkesë dhe në deklaratat e paraqitura nga themeluesi/pronari i vetëm dhe nga drejtuesi, përmbante të dhëna të pasakta për emrin e personit juridik - transmetuesit ("Shoqëri Tregtare Radiodifuzive RADIO PELA ShPKNjP Krivogashtani"), që nuk është harmonizuar me emrin ekzistues të personit juridik -transmetuesit, në pajtim me gjendjen aktuale të lëshuar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Shoqëria Tregtare Radiodifuzive RADIO PELA ShPKNjP fsh.Malo Konjari, Prilep") si dhe mungon Shtojca nr.1 (ndaj formularit të Kërkesës) dhe në deklaratat e paraqitura për vazhdimin e lejes (Shtojcat nr.2 dhe nr.2.1 ndaj Kërkesës), pas numrit të lejes mungon data e lëshimit.

Për sa më sipër, Agjencia më datë 16.04. 2026 i dërgoi aplikuesit për vazhdimin e lejes, shkresë me shkrim - Njoftim për korrigjimin dhe plotësimin e kërkesës (PA1 nr.08-313, datë 16.04.2026). Përmes këtij njoftimi, transmetuesi u informua se është e nevojshme të bëhet plotësimi dhe korrigjimi i Kërkesës së paraqitur, me qëllim që të mundësohet vijimi i procedurës për vazhdimin e lejes brenda afatit të paraparë ligjor.

Më datë 28.04.2026, aplikuesi i ka paraqitur Agjencisë plotësimin e Kërkesës për vazhdimin e lejes (PA1 nr.08-313) me vulë (vulë rrethore) e cila përmban emrin e saktë të transmetuesit, Certifikatën për sanksione kundërvajtëse, përmes së cilës u vërtetua se për transmetuesin nuk ekzistojnë të dhëna për shqiptimin e sanksionit kundërvajtës -ndalesë për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë ose detyrës (Shtojca nr.1 ndaj Kërkesës), si dhe deklaratat e harmonizuara për vazhdimin e lejes nga themeluesi/pronari i vetëm i transmetuesit dhe nga drejtuesi i transmetuesit, në të cilat është shtuar edhe data e lëshimit të lejes (Shtojca nr.2 dhe nr.2.1 ndaj Kërkesës). Pas shqyrtimit të Kërkesës (PA1 nr.08-313 të datës 16.04.2026, të plotësuar më datë 28.04.2026) për vazhdimin e lejes për transmetim në radio, së bashku me të gjithë dokumentacionin shoqërues, u konstatua se e njëjta është e saktë dhe e plotë.

Gjithashtu, Agjencia konstatoi se gjatë kohëzgjatjes së lejes, aplikuesi- ShTR RADIO PELA ShPKNJ P fsh.Malo Konjari, Prilep i përmbush kushtet e përcaktuara në nenin 79 të LShMAAV-së, përkatësisht nuk ka kryer shkelje serioze të përcaktuara në nenin 79, paragrafi (4) të LShMAAV-së.

Duke marrë parasysh sa më sipër, dr. Zoran Trajčevski, drejtori i Agjencisë, i dorëzoi Këshillit të Agjencisë Propozimin, (PA1 nr.08-313, datë 11.05.2026), për miratimin e vendimit për vazhdimin e Lejes për transmetim në radio të ShTR RADIO PELA SHPKNJ P fsh.Malo Konjari, Prilep, (PA1 nr.08-313, datë 03.07.2017), vlefshmëria e së cilës prej nëntë vitesh skadon më 14.05.2026, me propozim që e njëjta të vazhdohet për kohëzgjatje prej 9 (nëntë) vitesh, përkatësisht nga data 15.05.2026 deri më 14.05.2035.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 2, nenit 20, paragrafi (1) nënparagrafi 10², nenit 24 dhe nenit 79, paragrafët 1, 2 dhe 3 të LShMAAV-së, në pajtim me nenin 15, paragrafi (1), nënparagrafi 2, nenin 41, paragrafi (1), nënparagrafët 8 dhe 11 dhe nenin 59, paragrafët (1), (2) dhe (3) të Rregullores së Punës së Agjencisë, si dhe nenin 51, paragrafët (1) dhe (2) nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative, duke vepruar sipas Kërkesës (PA1 nr.08-313, datë 09.04.2026), me plotësimet (PA1 nr.08-313, datë 28.04.2026) për vazhdimin e lejes për transmetim në radio të ShTR RADIO PELA ShPKNJ P fsh.Malo Konjari, Prilep, Këshilli i Agjencisë miratoi Vendimin si në dispozitiv, i cili është përfundimtar dhe pas miratimit do të botohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në faqen e internetit të Agjencisë.

Agjencia do t'i lëshojë leje të re ShTR RADIO PELA ShPKNJ P fsh.Malo Konjari, Prilep, për vazhdimin e lejes nga pika 1 e këtij Vendimi. Transmetuesi është i detyruar që gjatë periudhës për të cilën vazhdohet leja, të punojë në pajtim me LShMAAV-në, Ligjin e Mediave, dispozitat e miratuara në bazë të ligjit, si dhe në pajtim me kushtet e përcaktuara në leje. Padia nuk e pezullon zbatimin e Vendimit.

**Agjencia e Shërbimeve Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
mr. Sasho Stefanovski d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, transmetuesi nga pika 1 e këtij Vendimi, ka të drejtë të ngrejë padi për iniciimin e kontestit administrativ pranë gjykatës kompetente, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të Vendimit.

² Nënparagrafët 8 dhe 9 fshihen, shih: nenin 8 nga Ligji i ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.248/18).

Përktheu: Antoneta Shabani